



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

**RREGULLORE  
PËR  
ORGANIZIMIN E TESTIMIT TË KANDIDATËVE PROFESIONISTË TË  
SHKENCAVE TEKNIKE MJEKËSORE PËR VENDET VAKANTE NË  
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.**

**TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Organizimi i testimit**

Organizimi i testimit të kandidatëve profesionistë të shkencave teknike mjekësore në institucionet shëndetësore publike zhvillohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përshkruara në këtë rregullore.

**Neni 2**

**Qendrat e testimit dhe afatet e zhvillimit të testimit**

Qendrat e testimit ngrihen në institucionet shëndetësore të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS). MShMS përcakton dhe publikon datën dhe orën e zhvillimit të testimit.

**Neni 3**

**Administrimi dhe monitorimi i testimit**

MShMS administron dhe monitoron procesin e testimit të kandidatëve për profesionistët e shkencave teknike mjekësore në institucionet shëndetësore publike në bashkëpunim me Komisionet e Vlerësimit të ngritura prej saj dhe institucionet shëndetësore ku janë ngritur qendrat e testimit.

## **Neni 4**

### **E drejta e pjesëmarrjes në testim**

Në testimin e kandidatëve për vendet vakante të profesionistëve të shkencave teknike mjekësore kanë të drejtë të marrin pjesë:

- a. Kandidatët që janë pranuar në fazën e parë të konkurrimit nëpërmjet vlerësimit të dosjes, fazë e cila zhvillohet në çdo rajon sipas udhëzimit përkatës të MShMS-së.
- b. Kandidatët që kanë marrë pjesë në testimin “Infermierë për Shqipërinë” të vitit paraardhës dhe që dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e tyre.

Kandidatët e parashikuar sipas pikës (a) e (b) të këtij neni regjistrohen online në platformën “Infermierë për Shqipërinë”.

## **Neni 5**

### **Vlerat udhëheqëse dhe karakteristikat e procesit të testimit**

Procesi i testimit udhëhiqet nga parimet dhe vlerat e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe meritës së kandidatëve. Karakteristikat e procedurës së testimit janë:

- a. Ruajtja e fshehtësisë së testeve
- b. Korrektësia e kandidatëve
- c. Korrektësia e administrimit
- d. Vlerësimi i standartizuar

## **KREU II**

### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE DHE PERSONAVE TË AUTORIZUAR**

## **Neni 6**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e MSHMS**

MShMS është përgjegjëse për administrimin e portalit online "Infermierë për Shqipërinë". Këtu përfshihet:

- a) shpall njoftimet për vendet vakante
- b) shpall njoftimet në lidhje me mënyrën dhe afatet e aplikimit online;
- c) harton dhe publikon programe orientuese të testimit sipas profileve përkatëse;
- d) cakton hartuesit dhe vlerësuesit e testeve për çdo profil;
- e) koordinon hartimin e testeve dhe i dërgon në qendrat e testimit;
- f) mbledh testet e sjella nga rajonet;
- g) koordinon procesin e vlerësimit të testeve;
- h) bën njoftimet për vendimet e ankimit;

- i) shpall listat me renditjen e kandidatëve për të gjitha fazat e procesit në portalin "Infermierë për Shqipërinë".

## **Neni 7**

### **Detyrat e Institucioneve Shëndetësore**

Institucioni shëndetësor ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) informon kandidatët për procedurat dhe rregullat e procesit të testimit;
- b) përcakton mjediset ku do të zhvillohet testimi dhe njofton MShMS-në;
- c) cakton numrin e kandidatëve në testim sipas mjediseve përkatëse;
- d) cakton administratorët për çdo mjedis dhe njofton me shkrim MshMS;
- e) siguron bazën materiale për zhvillimin e testit;
- f) mban përgjegjësi për zhvillimin korrekt të testimit, bashkë me administratorët;
- g) kthen dhe dorëzon tek Komisioni i Vlerësimit, në përfundim të testimit, kutitë me fletëtestet dhe procesverbalet përkatëse.
- h) largon kandidatët dhe administratorët nga testimi, kur konstaton moszbatim të rregullave të testimit;
- i) lejon të futen në mjediset e testimit vetëm personat e autorizuar nga MShMS;
- j) harton procesverbalin dhe e dërgon në MshMS.

## **Neni 8**

### **Detyrat e administratorit të testimit**

Administratori i testimit përcaktohet nga institucioni shëndetësor ku bëhet testimi dhe ka këto detyra:

- a) është përgjegjës për marrjen në dorëzim të fletëtesteve, shpërndarjen dhe mbledhjen e tyre për/nga kandidatët sipas procesverbaleve përkatëse;
- b) kryen sekretimin e testeve siç përcaktohet në nenin 9.
- c) organizon zhvillimin korrekt të testimit;
- d) respekton orarin e zhvillimit të testimit;
- e) sigurohet për identitetin e kandidatit nëpërmjet dokumentit vetjak zyrtar të identifikimit, përpara fillimit të testimit;
- f) sigurohet që çdo kandidat është ulur në vendin e paracaktuar;
- g) njeh kandidatët me rregullat e zhvillimit të testimit dhe me masat e mundshme disiplinore;
- h) u shpërndan fletëtestet kandidatëve, duke e pajisur secilin me fletëtestin përkatës;
- i) nuk lejon asnjë person të paautorizuar të futet në mjedisin e testimit;
- j) nuk lejohet të mbajë celular në mjedisin e testimit;
- k) njofton menjëherë titullarin e institucionit shëndetësor dhe MshMS, kur shfaqen parregullsi që cenojnë mbarëvajtjen e testimit;
- l) harton procesverbalin e testimit.

## **Neni 9**

## **Sekretimi i testeve**

- a) Procesi i sekretimit të testeve realizohet nga administratori i testimit.
- b) Sekretimi i testeve bëhet me anë të kodeve.
- c) Në secilin test ka një vend të caktuar ku vendoset kodi.
- d) Sekretimi i testeve fillon menjëherë, pasi ka filluar procesi i zhvillimit të testimit.
- e) Sekretuesi vendos kodin në test dhe në listën emërore të kandidatëve, të përgatitur nga MShMS. Kandidati nënshkruan pasi të ketë verifikuar emrin në listë.

### **Neni 10**

#### **Rregullat për kandidatët pjesëmarrës në testim**

1. Kandidatit pjesëmarrës në testim nuk i lejohet:
  - a. të marrë ose të japë informacion ose kopje nga një kandidat tjetër;
  - b. të komunikojë me një kandidat tjetër;
  - c. të bëjë komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit gjatë kohës së zhvillimit të testimit;
  - d. të mbajë celular ose mjet tjetër të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit;
  - e. të plotësojë testin me laps;
  - f. të shkruajë në fletën e testit ndonjë shënim tjetër përveç atyre që kërkon testi;
  - g. të ketë me vete materiale të tjera, si: libra, fletore, fletë të bardha etj.;
  - h. të ndërrojë vendin e paracaktuar.
2. Kandidati që ka shkelur një nga pikat e mësipërme, sipas raportimit me shkrim të administratorit përkatës, largohet nga testimi.

### **KREU 3**

#### **ORGANIZIMI I TESTIMIT**

### **Neni 11**

#### **Programet orientuese**

- a) Programet orientuese hartohen nga MShMS;
- b) Programet orientuese publikohen në portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

### **Neni 12**

#### **Struktura e testit**

Testi përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban pyetje rreth ligjeve që rregullojnë kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe çështje që lidhen me etikën dhe komunikimin profesional.
- b) Pjesa e dytë përmban pyetje rreth kujdesit infermieror bazë dhe në specialitete.

### **Neni 13**

## **Qendrat e testimit**

Në qendrat e testimit:

- a) Lista e kandidatëve dhe vendi i secilit kandidat shpallet në një vend të dukshëm të qendrës së testimit.
- b) Kandidatët qëndrojnë jo më pak se 1,2 m larg njëri-tjetrit.
- c) Në mjedisin e testimit lejohen të hyjnë ose të qëndrojnë vetëm administratori dhe persona të autorizuar nga MShMS;
- d) Numri i kandidatëve për 1 administrator është jo më i madh se 20;

### **Neni 14**

#### **Hartimi dhe vlerësimi i testeve**

- a) Hartimi i testeve mbështetet në programet e orientuara të shpallura në portalin “Infermierë për Shqipërinë”. Hartuesit e testeve caktohen nga MShMS.
- b) Një test vlerësohet nga një grup i përbërë nga jo më pak se dy vetë, të cilët janë antarë të komisionit të vlerësimit.
- c) Komisioni i vlerësimit vlerëson me pikë secilën nga dy pjesët e testit dhe veçon testet e dyshuara për kopjim.
- d) Pikët e kandidatit për secilën pjesë të testit vendosen në krye të fletëtestit dhe testi nënshkruhet nga vlerësuesit.
- e) Vlerësimi përfundimtar i kandidatit bëhet me sistemin e 70 pikëve, i cili përbëhet nga pikët e pjesës së parë të testit (20 pikë) dhe nga pikët e pjesës së dytë të testit (50 pikë).

### **Neni 15**

#### **Ankimi**

Kandidatët kanë të drejtë të ankohen me shkrim për procesin e testimit në MShMS brenda pesë ditëve nga shpallja e rezultatit. Nëse ankesa e kandidatit gjykohet e drejtë, testi i ankuesit rivlerësohet. MShMS shpall rezultatet e kandidatëve mbas ankimit.

### **Neni 16**

#### **Konflikti i interesit**

Hartuesit e testit, vlerësuesit e testit, administratorët, personat e autorizuar nga MShMS nuk duhet të kenë lidhje familjare me kandidatët (bashkëshort/bashkëshorte, prind vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes).

## **KREU 4**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 17**

#### **Ruajtja e dokumentacionit**

Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në institucionet përkatëse për 1 (një) vit dhe janë objekt i inspektimit të institucioneve të autorizuara nga ligji.

**Neni 18**  
**Mbulimi i shpenzimeve**

Shpenzimet për realizimin e testimit përballohen nga buxheti i institucioneve që përfshihen në këtë proces, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Neni 19**  
**Zbatimi i udhëzimit**

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi institucionet shëndetësore dhe sektorë të caktuar në MShMS. Kjo rregullore botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**OGERTA MANASTIRLIU**

